



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

AD.GJTH.GJL.nr.18/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, duke vepruar sipas ankesës së datës 30.09.2024¹ të parashtruar nga ankuesi K. K. nga Gjilani, Rr. “Nijazi Kadriu”, nr.93, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtares M. A. – gjyqtare në Gjykatën Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, më datë 17.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e parashtruar nga ankuesi K. K. nga Gjilani, e datës 30.09.2024, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtares M. A. – gjyqtare në Gjykatën Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Më datë 30.09.2024, parashtruesi i ankesës K. K. ka paraqitur ankesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke theksuar se gjyqtarja M. A. gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare si gjyqtare në Divizionin Civil të Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Gjilan, në lëndën C.nr.334/22, sipas padisë së paditësit A. I. kundër të paditurit K. K., ka keqpërdorur detyrën zyrtare, ashtu që në mënyrë të kundërligjshme e ka larguar të autorizuarën e avokatit H. J., juristen V. Sh. nga salla e gjykimit dhe ka vazhduar mbajtjen e seancës, përkundër që sipas ligjit ka qenë e detyruar të caktojë seancë të re. Për këtë arsye ka kërkuar iniciimin e procedurës ndaj të njëjtës gjyqtare.

Pas shqyrtimit të ankesës, bazuar në nenin 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, autoriteti kompetent konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar dhe nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore.

¹ Përcjellur përmes lëndës pretendime për shkelje disiplinore, nr.01/971 më datë 11.10.2024 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe pranuar në Gjykatën Themelore në Gjilan më datë 15.10.2024.

Pretendimet e ankuesit nuk konsistojnë në shkeljet disiplinore të parapara me këtë ligj, pasi sa i përket gjyqtares M. A., kryetari i gjykatës ka konstatuar se në lëndën C.nr.334/22, gjendet procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 02.08.2024, në të cilën është evidentuar se në bazë të autorizimit gjeneral të avokatit H. J. për të përfaqësuar të paditurin K. K. në këtë çështje kontestimore, nuk është paraparë mundësia e të drejtes së bartjes së autorizimit te personat e tjerë, e nga kjo arsye është larguar nga salla juristja V. Sh..

Kryetari i gjykatës vlerëson se kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj një gjyqtari bazohet në shkeljet disiplinore të cilat janë të rradhitura taksativisht në nenin 5 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, e nuk kanë të bëjnë me mënyrën e vendosjes së gjyqtares së çështjes, përkatësisht vendimet procedurale që ndërlidhen me zhvillimin e çështjes, e gjithashtu pretendimet e ankuesit nuk bien ndesh as me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

Ankuesi në anën tjetër ka të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike ligjore për të kundërshtuar një vendim që e konsideron jo të drejtë dhe të ligjshëm, e në rastin konkret pretendimet e të njëjtit janë të orientuara në këtë drejtim dhe nuk mund të prodhojnë efekt në procedurë disiplinore.

Andaj kryetari i kësaj gjykate, konform nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, ka gjetur se ankesa e parashtruesit K. K. nga Gjilani, e datës 30.09.2024, është e pabazuar dhe për të njëjtën ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Kryetari i Gjykatës,
Venhar Salihu**

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Parashtruesit të ankesës,
2. KGJK-së
3. Dosjës së lëndës.